REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE PUBLIKE, ZHVILLIMIT URBAN DHE RURAL
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT, ZHVILLIMIT TË TERRITORIT DHE MJEDISIT

Nr. 8737 Prot. Lushnjë 14 / 09 / 2026

RELACION

KËSHILLIT BASHKIAK
(këtu)

"PËR MIRATIMIN E PRISHJES SË OBJEKTIT :SHKOLLA "9-VJECARE" KASHTËBARDHË NDODHUR NË PASURINË ME NR. 51/1 ZK. 2110, NJËSIA ADMINISTRATIVE KARBUNARË ,BASHKIA LUSHNJË" .

Të nderuar këshilltare/ këshilltarë

Me shkresën e ardhur në institucionin Bashkia Lushnjë nr.497 prot. datë 09/09/2026 Zyra e Qëndrës së Arsimit na informon mbi gjëndjen faktike te objektit të shkollës 9 Vjeçare Kashtëbardhë, ku konstatohen këto problematika:

1. Objekti sot është në gjendje të rrënuar, si pasojë e një defekti në instalimet elektrike, i cili ka shkaktuar një shkëndijë elektrike dhe më pas zjarr, duke sjellë dëmtime të konsiderueshme në elementët konstruktivë dhe arkitektonikë.

2. Objekti si pasojë e dëmtimeve ka humbur qëndrueshmërinë e tij pra nuk ka elementë konstruktiv të qëndrueshëm për rrjedhojë e bën të pamundur rikonstruksionin e tij .

3. Sot objekti është totalisht i degraduar, me mungesë të çatisë/soletës mbuluese dhe vetëm me mbetje të elementeve murale të godinës së mëparshme.

4. Përshtatja e strukturës ekzistuese për një funksion të ri nuk paraqitet si zgjidhje e përshtatshme teknike dhe funksionale.

Me shkresën e ardhur në institucionin Bashkia Lushnjë me nr. 613/1 prot. datë 10/09/2026 Njësia Administrative Karbunarë na informon se numri i pasurisë së objektit :Shkolla 9 Vjeçare Kashtebardhë është 51/1, Zk 2110, pronë shtet, lloji i pasurisë Truall me sipërfaqe 5275 m², dhe sipërfaqe ndërtese 677 m².
Në këto kushte, pas analizimit të gjendjes teknike të objektit, është konstatuar se godina është jashtë funksionit. Bazuar në këto kushte paraqitet e nevojshme prishja (shembja) e objektit.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

Konc. Ark. Alban Manoku

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Të Territorit
Ing. Ariola Beqo

Adresa:Lagjja Kongresi Lushnjes Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK LUSHNJË

Nr. 8737/1 Prot. Lushnjë, më 14.09.2026

PROJEKT-VENDIM

NR. 85 DATË 14/09/2026

"PËR MIRATIMIN E PRISHJES SË OBJEKTIT SHKOLLA "9 VJEÇARE" KASHTËBARDHË, NDODHUR NË PASURINË ME NR. 51/1, ZK. 2110, NJËSIA ADMINISTRATIVE KARBUNARË, BASHKIA LUSHNJË"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e radhës në datë ____/____/2026, sipas relacionit të paraqitur nga Drejtoria Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Mjedisit, në mbështetje të nenit 9 pika 1.2/a/c dhe neni 54, shkronja "e", të Ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenit 113, pika 2 të Kushtetutës se Republikës të Shqipërisë, nenit 4, neni 5, pika 1.3, shkronja a, neni 12, neni 22 të ligjit nr.107 datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar. Ju

PROPOZOJMË:

I. Të miratoj prishjen e objektit shkolla "9-vjeçare" Kashtëbardhë, ndodhur në pasurinë me nr. 51/1, ZK 2110 Njësia Administrative Karbunarë, Bashkia Lushnjë.

II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor, Policia Bashkiake, Ndërmarrja e Pasurisë Publike, Njësia Administive Karbunarë, Bashkia Lushnjë.

III. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpallijes.

Drejtoria e Planifikimit

Ariola Beqo

Drejtor Juridik

Bedri Hida

KRYETAR I BASHKISË

Erselda Sefa

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 3[illegible]222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com